

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ALFRED AGOLLI

07/08/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 04.07.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Agolli , bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 08.07.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Alfred Agolli, drejtues i Prokurorisë së Apelit Gjirokastër.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyquese i kryesuar nga znj. Etleda Çiftja, z. Roland Ilia relator, z. Olsi Komici anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.